

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 128 Prot.

Tiranë, më 30 . 01 2017

VENDIM Nr. 13, datë 24.01.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 1 të datës 24.01.2017, pasi shqyrtoi *Raportin e sondazheve arkeologjike në korridorin e ndërtimit të Gazsjellësit - TRANS ADRIATIK PIPELINE (TAP)* në zonën e Bellovodë. Floq. KM: 53+000. KM: 54+000, paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Raportin e sondazheve arkeologjike në korridorin e ndërtimit të Gazsjellësit - TRANS ADRIATIK PIPELINE (TAP)* në zonën e Bellovodë, Floq. KM: 53+000, KM: 54+000, paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k., të kryejë dokumentimin e kanalit, i cili në të gjithë gjatësinë e tij ka gurë të ngulur në mes, të zbuluar gjatë sondazheve në zonën e Bellovodë, Floq. KM: 53+000, KM: 54+000, paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k., si dhe të marrë masat për rehabilitimin e zonës.
3. Të vijojnë punimet e ndërtimit të tubacionit të Linjës së gazsjellësit TAP, sipas akt-marrëveshjes tre palëshe, të lidhur ndërmjet "TAP AG", shoqërisë së licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k. dhe ASHA, të përcaktuar në pikën 3 të vendimit të KKA Nr. 99, datë 14.09.2016, për projektin "Linja e Gazsjellësit TRANS ADRIATIK (TAP), Fushata e Dytë, KM 0 - KM 69".
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO